| 1.3. nuk zbatohet vendimi në rastet e jashtëzakonshme dhe emergjente; | 1.3.decision does not apply in extraordinary and emergency cases; | 1.3. ne primenjuje odluka u vanrednim i hitnim slučajevima; |
| 1.4. në bashkëpunim me organet e policisë, mbikqyrja inspektive ushtrohet kur është e nevojshme edhe në çdo kohë. | 1.4. in cooperation with the police, inspection supervision exercised when necessary, also after closing time of the operation of the facility. | 1.4. u saradnji sa policijom, inspekcijski nadzor vrši po potrebi i van vremena funkcijonisanja objekta. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 37**<br>**Bashkëpunimi me institucionet tjera profesionale**<br><br>Inspektori mundet të kërkojë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante, nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike.<br><br>**Neni 38**<br>**Procesverbali**<br><br>1. Për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori harton procesverbal.<br><br>2. Inspektori dhe subjekti i mbikëqyrjes e nënshkruajnë procesverbalin pas kryerjes së inspektimit dhe një kopje e procesverbalit i mbetet subjektit të mbikqyrjes.<br><br>3. Me përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni, kur për shkak të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes inspektuese, natyrës së saj dhe rrethanave, procesverbali mund të përgatitet në hapësirat zyrtare të shërbimit inspektues në afat prej tre (3) ditësh nga dita e | **Article 37**<br>**Cooperation with other professional institutions**<br><br>The inspector may require the inspection procedure within the opinion and cooperation of relevant institutions, whether it is necessary for fair evaluation of the factual situation.<br><br>**Article 38**<br>**Minutes**<br><br>1. To perform the inspection supervision, the inspector compiles a minutes.<br><br>2. Inspector and subject of supervision will sign the record of inspection and a copy of the report remains to the subject of supervision.<br><br>3. With the exception of paragraph 1. of this section, where due to the volume and complexity of the inspection, its nature and circumstances, the record can be prepared on official premises inspection service within three (3) days of supervision, with the explanation and the reasons for this. | **Član 37**<br>**Saradnja sa drugim stučnim institucijama**<br><br>Inspektor može da zahteva u okviru inspekcijskog postupka mišljenje i stručnu saradnju relevantnih institucija, ako je potrebno za pravilnu procenu činjeničnog stanja.<br><br>**Član 38**<br>**Zapisnik**<br><br>1. Za obavljanje inspekcijskog nadzora, inspektor izrađuje zapisnik.<br><br>2. Inspektor i nadzorni subjekt potpisuju zapisnik nakon izvršenja inspekcije i jedna kopija zapisnika ostaje nadzornom subjektu.<br><br>3. Sa izuzetkom iz stava 1. ovog člana, kada zbog obima i složenosti inspekcijskog nadzora, svoje prirode i okolnosti, zapisnik se može pripremati u službenim prostorijama inspekcijske službe u roku od tri (3) dana od dana nadzora uz obrazloženje i razloga za to. |

| | | |
|---|---|---|
| mbikëqyrjes me arsyetim dhe shkaqet për këtë. | | |
| 4. Kopja e procesverbalit nga paragrafi 3. i këtij neni, i dorëzohet për nënshkrim subjektit të mbikëqyrjes. | 4. A copy of the minutes from paragraph 3. of this article is submitted for signature to the supervision subject. | 4. Primerak zapisnika iz stava 3. ovog člana, dostavlja se za potipisivanje nadzornom subjektu. |
| 5. Nëse subjekti i mbikëqyrjes në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të procesverbalit nuk prononcohet në lidhje me procesverbalin e dorëzuar, ose nuk ia kthen të nënshkruar inspektorit, konsiderohet se subjekti i mbikëqyrjes është pajtuar me procesverbalin nga mbikëqyrja e kryer inspektuese. | 5. If the subject of supervision within eight (8) days of receipt of the record, do not pronounce about the record submitted, or does not return back toe the inspector with his signature, it will be considered that the subject of supervision is agreed with the record of the inspection supervision. | 5. Ako nadzorni subjekt u roku od osam (8) dana od dana prijema zapisnika ne izjavi u vezi sa dostavljenim zapisnikom, ili ne vrati potpisanog inspektoru, smatra se da se nadzorni subjekt složio sa zapisnikom od izvršenog inspekcijskog nadzora. |
| 6. Nëse subjekti i mbikëqyrjes refuzon ta nënshkruajë procesverbalin, inspektori do t'i cekë arsyet për refuzim. | 6. If the subject refuses to sign the minutes of supervision, the inspector will state the reasons for rejection. | 6. Ako nadzorini subjekt odbije da potpiše zapisnik, inspektor će navesti razloge za odbijanje. |
| 7. Në procesverbal shënohet emri i organit inspektues i cili e kryen mbikëqyrjen, vendi, dita dhe ora kur fillon dhe kryhet mbikëqyrja, lënda e mbikëqyrjes, emrat e inspektorëve, të personave të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre dhe të autorizuarit. | 7. In the record will be noticed the name of the body that performs inspection supervision, the place, day and time when it starts and performed supervision, case of supervision, the names of inspectors, the persons present and their representatives and the attorney. | 7. U zapisniku se označava ime inspekcijskog organa koji vrši nadzor, mesto, dan i vreme kada počinje i završava nadzor, predmet nadzora, imena inspektora, prisutinih lica i njihovih predstavnika i ovlastitelja. |
| 8. Procesverbali doemos duhet të hartohet | 8. Minutes must be drafted clearly and | 8. Zapisnik se mora pripremiti na jasan i |

| | | |
|---|---|---|
| shkurt në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. | understandable. | razumljiv način. |
| 9. Procesverbali duhet të përmbajë pasqyrim për gjendjen faktike, vërejtjet, deklaratat, rrethanat dhe faktet tjera relevante të konstatuara gjatë mbikqyrjes inspektive. | 9. The record must include coverage for the actual situation, remarks, statements and other relevant circumstances and facts found during surveillance inspection. | 9. Zapisnik treba da sadrži odraz o činjeničnom stanju, primedbe, izjave, okolnosti i druge relevantne činjenice konstantovanih tokom inspekcijskog nadzora. |
| 10. Formën dhe elementet obliguese të përmbajtjes së procesverbalit për mbikqyrje inspektive, i përcakton Ministri. | 10. Binding elements of the form and content of the records for inspection supervision, determines the Minister. | 10. Oblik i obavezne elemente sadržaja zapisnika o inspekcijskom nadzoru određuje Ministar. |
| **Neni 39**<br>**Mbikëqyrje inspektuese te subjektet e panjohura** | **Article 39**<br>**Inspection supervision of unknown subjects** | **Član 39**<br>**Inspekcijski nadzor nepoznatih subjekata** |
| 1. Në rastet kur inspektori nuk mund të identifikojë se cili është subjekt mbikëqyrës, inspektori i lenë ftesë subjektit të panjohur në vend ngjarje të inspektimit duke e informuar që në ditë të caktuar të jetë i pranishëm për inspektim. | 1. In cases where the inspector can not identify which is subject to oversight, the inspector leaves the invitation of the unknown entity in the scene by informing the inspection that particular day to be present for inspection. | 1. U slučajevima kada inspektor ne može da identifikuje koji je nadzorni subjekt, inspektor ostavlja poziv nepoznatom subjektu na mestu uviđaja inspekcije obaveštavajući da u utvrđeno vreme bude prisutan za inspekciju. |
| 2. Nëse subjekti i panjohur i mbikëqyrjes nuk i përgjigjet ftesës nga paragrafi 1. i këtij neni, mbikëqyrja inspektuese kryhet pa praninë e personit përgjegjës të | 2. If unknown entity does not respond to supervision from paragraph 1. of this article, surveillance inspection carried out without the presence of the responsible person subject to | 2. Ako nepoznati subjekt ne odgovori pozivu iz stava 1. ovog člana, inspekcijski nadzor se vrši bez prisustva odgovornog lica nadzornog subjekta. |

| | | |
|---|---|---|
| subjektit të mbikëqyrjes. | supervision. | |
| **KREU XI<br>KONKLUZIONI DHE AKTVENDIMI NË PROCEDURËN INSPEKTIVE** | **CHAPTER XI<br>CONCLUSION AND DECISION-RULING ON INSPECTIVE PROCEDURE** | **POGLAVLJE XI<br>ZAKLJUČAK I REŠENJE U INSPEKCIJSKOM POSTUPKU** |
| **Neni 40** | **Article 40** | **Član 40** |
| Gjatë procedurës së mbikëqyrjes inspektive, inspektori nxjerr konkluzion dhe aktvendim. | During the monitoring procedure, the environmental inspector issues a conclusion and decision. | Tokom procedure inspekcijskog nadzora, inspektor donosi zaključak i rešenje. |
| **Neni 41<br>Konkluzioni** | **Article 41<br>Conclusion** | **Član 41<br>Zaključak** |
| 1. Me konkluzion vendoset për çështjet e procedurës të cilat paraqiten gjatë procedurës së mbikëqyrjes inspektive. | 1. With the conclusion of the procedure it's decided for issues that arise during the procedure of inspection supervision. | 1. U zaključku se odlučuje o pitanjima postupka koji se pojavljuju u toku postupka inspekcijskog nadzora. |
| 2. Konkluzioni me shkrim nxirret vetëm në rastet, kur në konkluzion është e lejuar ankesa. | 2. Written conclusion will be draw only in cases when in the conclusion complains is allowed. | 2. Napismeni zaključak donosi se samo u slučajevima, kada je u zaključku dozvoljena žalba. |
| **Neni 42<br>Aktvendimi** | **Article 42<br>Decision** | **Član 42<br>Rešenje** |
| 1. Nese inspektori gjatë procedures inspektive konstaton parregullësi ligjore | 1. If the inspector finds irregularities during the inspection procedure and the same law | 1. Ako inspektor tokom inspekcijskog postupka utvrdi zakonske nepravilnosti i iste |

| | | |
|---|---|---|
| dhe të njejtat parregullësi i konstaton edhe ne procesverbal, atëherë edhe me vendim mundet te percaktoj afatin e mënjanimit të parregullësive. | determines the irregularity of the record, then the decision shall specify the time of removal of irregularities. | nepravilnosti utvrdi i u zapisniku, tada odlukom utvrđuje rok otklanjanja nepravilnosti. |
| 2. Inspektori në bazë të fakteve të konstatuara në procedurë inspektive, do të nxjerr aktvendimin në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve. | 2. Inspector based on facts found in the inspection procedure, shall issue a decision within fifteen (15) days. | 2. Inspektor na osnovu utvrđenih činjenica u inspekcijskom postupku, donosi rešenje u roku od petnest (15) dana. |
| 3. Gjatë procedures inspektive, kur inspektori konstaton rrezikun e drejtëpërdrejt për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe të njejtin rrezik e konstaton në proceverbal, atëherë inspektori mund të shqiptojë masën e vendimit gojor. | 3. During the inspection procedure, the inspector determines the direct risk to life and health of people and the same risk notice in the inspection records, the inspector can enounce a measure of verbal decision. | 3. U toku inspekcijskog postupka, kada inspektor utvrdi direktnu opasnost po život i zdravlje ljudi i istu opasnost utvrdi u zapisniku, tada inspektor može da izrekne meru usmene odluke. |
| 4. Në rastin nga paragrafi 3, të këtij neni, inspektori është i detyruar që në afat prej tre (3) ditëve nga dita e shqiptimit të vendimit me gojë, të nxjerr aktvendim me shkrim. | 4. In the case of paragraph 3. of this article, the inspector is obliged that within three (3) days of the oral pronouncement of the decision, to issue a written decision. | 4. U slučaju iz stava 3. ovog člana, inspektor je zadužen da u roku od tri (3) dana izrekne usmenu odluku, i da donese pismeno rešenje. |
| **Neni 43**<br>**Ankesa** | **Article 43**<br>**Complaints** | **Član 43**<br>**Žalba** |
| 1. Kundër aktvendimit të inspektorit të Ministrisë nga neni 42 i këtij Ligji, mund të ushtrohet ankesë në afat prej | 1. Against the decision of the inspector of Ministry under article 47 of this Law, may be appealed within fifteen (15) days of receipt of | 1. Protiv rešenja inspektora Ministarstva iz člana 47 ovog Zakona, može se pokrenuti žalba u roku od petnest (15) dana od dana |

| | | |
|---|---|---|
| pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. | the decision. | prijema rešenja. |
| 2.Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit në nivel lokal, shqyrtohet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në komunë, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. | 2. Appeal against decision of inspector at the local level, will be reviewed by the Committee of complaints in municipality, within 30 of receipt of decision. | 2. Žalba protiv rešenja inspektora na lokalnom nivou, razmatra se od strane Komisije za razmatranje žalbe u opštini, u roku od 30 dana od dana prijema rešenja. |
| 3. Kundër aktvendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave në komunë, mund të ushtrohet ankesë në Ministri, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. | 3. Against the decision of the Committee of complaints in municipality, may be appealed complaint to the Minister, within fifteen (15) days of receipt of the decision. | 3.Protiv rešenja Komisije za razmatranje žalbe u opštini, može se uložiti žalba u Ministarstvu, u roku od petnaest (15) dana od dana prijema rešenja. |
| 4.Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit të Ministrisë, shqyrtohet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Ministri. | 4. An appeal against the decision of the inspector of Ministry will be reviewed by the Committee of complaints of the Ministry. | 4. Žalba protiv rešenja inspektora Ministarstva, razmatra se od komisije za razmatranje žalbi u Ministarstvu. |
| 5. Kundër aktvendimit të Ministrisë, mund të iniciohet konflikt administrativ me padi në gjykatën kompetente brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi. | 5. Against the decision of the Ministry, administrative dispute may be initiated administrative dispute by indictment competent court within 30 days of receipt of this decision. | 5. Protiv rešenja Ministarstva, može se pokrenuti upravni spor tužbom pred nadležnim sudom u roku od 30 dana od dana prijema ove odluke. |

| Neni 44<br>Legjitimacioni zyrtar | Article 44<br>Official Authorization | Član 44<br>Zvanična legitimacija |
|---|---|---|
| 1. Inspektori i Ministrisë posedon legjitimacionin zyrtar, shenjën dhe pajisjen përkatëse. | 1. Inspector of the Ministry has the official legitimacy, sign and the appropriate equipment. | 1. Inspektor Ministarstva poseduje zvanični legitimitet, oznaku i relevantnu opremu. |
| 2. Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit e përcakton Ministri me akt nënligjor. | 2. The form and content of the legitimacy, determines the Minister by sub-legal act. | 2. Formu i sadržaj legitimiteta određuje Ministar podzakonskim aktom. |
| 3. Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit të inspektorit komunal e përcakton organi kompetent në nivel lokal. | 3. The form and content of the legitimacy of the municipal inspector determines by the local competent authority. | 3. Formu i sadržaj legitimiteta opštinskog inspektora određuje nadležni organ na lokalnom nivou. |
| **KREU XII<br>VEPRIME TË VEÇANTA NË PROCEDURËN INSPEKTUESE** | **CHAPTER XII<br>SPECIAL OPERATIONS IN INSPECTING PROCEDURE** | **POGLAVLJE XII<br>POSEBNE DELATNOSTI U INSPEKCIJSKOM POSTUPKU** |
| **Neni 45<br>Marrja e mostrave** | **Article 45<br>Sampling** | **Član 45<br>Uzimanje uzoraka** |
| 1. Inspektori mund të marrë mostër, nëse në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese është e nevojshme që të vërtetohet përbërja e lëndës në pajtim me këtë ligj dhe ligjet në fuqi. | 1. The inspector may take the sample, if the inspection procedure is necessary to verify the composition of matter in accordance with this law and laws in force. | 1. Inspektor može da uzme uzorak, ako je u nadzornom postupku potrebno da se utvrdi predmet u skladu sa ovim zakonom i zakonima na snazi. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Mënyrën dhe rocedurat e marrjes së mostrave i përcakton Ministri me akt nënligjor. | 2. Manner and procedure of sampling are determined by sub-legal act. | 2. Način i postupak uzorkovanja određuje ministar podzakonskim aktom. |
| **Neni 46**<br>**Konfiskimi i përkohshëm** | **Article 46**<br>**Temporary Confiscation** | **Član 46**<br>**Privremeno oduzimanje** |
| 1. Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese konstaton parregullësi, përkohësisht konfiskon dokumente, materiale, makina pune dhe mjete tjera të cilat mund të shfrytëzohen si dëshmi në procedurën përkatëse. | 1. If the inspector during the inspection finds irregularities, temporarily seize documents, materials, machines and other work that can be used as evidence in relevant proceedings. | 1. Ako inspektor tokom inspekcijskog nadzora utvrdi nepravilnosti, privremeno oduzme dokumente, materijale, radne mašine i druga sredstva koje može da koristi kao dokaz u relevantnom postupku. |
| 2. Mënyrën dhe procedurat e konfiskimit i përcakton Ministri me akt nënligjor. | 2. Method and seizure procedures are determined by sublegal act. | 2. Način i postupke oduzimanja određuje Ministar podzakonskim aktom. |
| **Neni 47**<br>**Ndërprerja e përkohshme e veprimtarisë** | **Article 47**<br>**Temporary interruption of activity** | **Član 47**<br>**Privremeni prekid aktivnosti** |
| 1. Nëse gjatë kontrollit dhe mbikqyrjes inspektive, Inspektori konstaton parregullsi që e rrezikojnë jetën, shëndetin, mjedisin dhe rastet tjera të përcaktuara me ligj, përkohësisht do të ndërprej kryerjen e veprimtarisë me vulosjen-blombimin, vendosjen e shiritit hapësirave, objekteve, kantierëve, | 1. If during the inspection and surveillance inspection, the inspector finds irregularities that threaten life, health, environment and other cases stipulated by law, will temporarily cease conducting business with the sealing-bar, setting the bar areas, facilities, construction sites, equipment, labor tools and other means, for removing the irregularities. | 1. Ako tokom kontrole i inspekcijskog nadzora, inspektor utvrdi nepravilnosti koje ugrožavaju život, zdravlje, sredinu i druge slučajeve određenih zakonom, privremeno će prekinuti aktivnost zapečatiranjem-blomiranjem, postavljanjem traka u prostore, objekte, kontenjere, opremi, radnoj opremi do uklanjanja nepravilnosti. |

| | | |
|---|---|---|
| pajisjeve, mjeteve të punës dhe mjeteve tjera, deri në mënjanimin e parregullsive. | | |
| 2. Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni, inspektori në bashkëpunim me organet kompetente urdhëron personat juridik të cilët kryejnë shërbime publike të furnizimit me ujë, rrymë elektrike dhe të ngjashme t'i ndërprej shërbimin subjektit të mbikëqyrjes. | 2. In cases from paragraph 1. of this article, the inspector orders the cooperation with competent legal entities that perform public services, water supply, electricity and related services to quit the service to the supervision subject. | 2. U slučajevima iz stava 1. ovog člana, inspektor u saradnji sa nadležnim organima naređuje pravnim licima koji obavljaju javne usluge snabdevanja vodom, električnom strujom i slično da prekinu usluge nadzornom subjektu. |
| 3. Personi juridik nga paragrafi 2, i këtij neni, është i detyruar që të veprojë sipas urdhërit të inspektorit. | 3. A legal person referred to in paragraph 2. of this article, is obliged to act under the direction of the inspector. | 3. Pravno lice iz stava 2. ovog člana, dužno je da postupi po naredbi inspektora. |
| 4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes vazhdon aktivitetin pas vendosjes së vulës-blombës, inspektori zbaton urdhërin e ndërprerjes së punës me ndihmën e policisë dhe zbaton masa ndëshkuese. | 4. If the subject of surveillance continues activity after the seal-bar, the inspector applies the cessation of work order with the help of police and implements punitive measures. | 4. Ako nadzorni subjekt nastavlja aktivnost posle postavljanja pečata-blombe, inspektor sprovodi nalog o prestanku rada uz pomoć policije i sprovodi kaznene mere. |
| 5. Vazhdimi i veprimtarisë nga subjekti i mbikqyrur pas vulosjes/vendosjes së shiritit, konsiderohet vepër penale. | 5. Continuing operations by the supervised subject after marking / bar setting, it is considered a criminal offense. | 5. Nastavljanje delatnosti od nadzornog subjekta nakon zapečačivanja/postavljanja trake, smatra se krivičnim delom. |
| 6. Urdhëresa për ndërprerjen e veprimtarisë ndaj subjektit të mbikëqyrur, shfuqizohet pas vendimit me shkrim të inspektorit. | 6. The order to stop activity of the supervised entity will be abolished after the written decision of the inspector. | 6. Naredba o prestanku aktivnosti prema nadzornom subjektu, ukinut će se nakon pismene odluke inspektora. |

| Neni 48<br>Gjobat mandatore | Article 48<br>Mandatory fines | Član 48<br>Obavezuječe kazne |
|---|---|---|
| 1. Gjatë mbikqyrjes, kontrollit inspektiv dhe në rastet kur haset në veprime ose aktivitete të kundërligjëshme, inspektori shqipton gjobë mandatore në pajtim me legjislacionin në fuqi. | 1. During the supervision, inspection control and in cases when meet the illegitimate actions or activities, the inspector enunciate the fines in accordance with applicable law. | 1. Tokom nadzora, inspekcijske kontrole i u slučajevima kada se javljaju protivzakonite aktivnosti, inspektor izriče mandatnu kaznu u skladu sa zakonom na snazi. |
| 2. Formën dhe përmbajtjen e formularit për ndëshkim me gjobë mandatore e përcakton Ministri kurse për njësitë e administrimit lokal, Kryetari i komunës. | 2. The form and content of the fine form for mandatory punishment is determined by the Minister and the local administration units, the Mayor. | 2. Formu i sadržaj obrasca za mandatnu kaznu određuje ministar dok za jedinice lokalne urave, Predsednik opštine. |
| **KREU XIII<br>SHPENZIMET E PROCEDURËS INSPEKTUESE** | **CHAPTER XIII<br>INSPECTING PROCEDURE COSTS** | **POGLAVLJE XIII<br>TROŠKOVI INSPEKCIJSKOG POSTUPKA** |
| **Neni 49<br>Shpenzimet e procedurës** | **Article 49<br>Costs of proceedings** | **Član 49<br>Troškovi postupka** |
| 1. Shpenzimet nga procedura inspektuese e cila është kryer pa shqiptimin e masës inspektuese, i bartë organi inspektues, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. | 1. Costs of inspection procedure which is performed without imposing the inspection measure will be covered by the inspection, unless otherwise specified by law. | 1. Troškovi od inspekcijskog postupka koja je izvršena bez izricanja kaznenih inspekcijskih mera, snosi inspekcijski organ, ako zakonom nije dugačije određeno. |
| 2. Shpenzimet nga procedura inspektuese e cila është kryer me shqiptimin e masës inspektuese i bart subjekti i mbikëqyrjes, | 2. Costs of inspection procedure which is performed by imposing inspection measure is carried by the subject of supervision, unless | 2. Troškovi inspekcijskog postupka koji je izvršen izricanjem inspekcijskih mera snosi nadzorni subjekt, ako zakonom nije |

| | | |
|---|---|---|
| nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. | otherwise specified by law. | drugačije određeno. |
| 3. Për shpenzimet e procedurës të cilat janë të njohura në momentin e miratimit të aktvendimit, vendoset në vet aktvendimin. | 3. For the costs of proceedings which are known at the time of adoption of the decision, is decided by that decision. | 3. Za troškove postupka koji su poznati u momentu usvajanja rešenja, odlučuje se u samom rešenju. |
| **KREU XIV<br>MBIKQYRJA E PËRBASHKËT INSPEKTUESE** | **CHAPTER XIV<br>JOINT SURVEILLANCE OF INSPECTING** | **POGLAVLJE XIV<br>ZAJEDNIČKI INSPEKCIJSKI NAZOR** |
| **Neni 50<br>Mbikëqyrje inspektuese nga më shumë organe inspektuese** | **Article 50<br>Supervision inspection by many inspection bodies** | **Član 50<br>Inspekcijski nadzor od više inspekcijskih organa** |
| 1. Mbikëqyrja inspektuese mund të kryhet njëkohësisht, nga më shumë organe inspektuese. | 1. Inspection can be performed simultaneously, from more inspection bodies. | 1. Inspekcijski nadzor može se istovremeno vršiti od više inspekcijskih organa. |
| 2. Mbikëqyrja e përbashkët inspektuese detyrimisht kryhet, nëse: | 2. Joint supervision of the inspection necessarily will perform, if: | 2. Zajednički nadzor nužno se vrši ako: |
| 2.1. është e domosdoshme për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë të jetës dhe shëndetit të njerëzve, çrregullimeve mjedisore ose pronës me vlerë të veçantë; | 2.1. is necessary to avoid imminent danger to life and health, environmental disturbances or property of significant value; | 2.1. je neophodno za otklanjanje neposredne opasnosti po život i ljudsko zdravlje, poremećaja sedine ili imovine od posebne vrednosti; |
| 2.2. është e domosdoshme për shkak të ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes | 2.2. is necessary due to the complexity of supervision or the importance of | 2.2. je neophodno zbog kompleksnosti nadzora ili značaja otklanjanja |

| | | |
|---|---|---|
| ose të rëndësisë së mënjanimit të mangësive; | eliminating the deficiencies; | nedostataka; |
| 2.3. kjo është e domosdoshme për kontrollë të objekteve me rëndësi të veçantë për turizmin, tregtinë, hotelerinë, trafikun dhe të tjera, për marrjen e mostrave, kontrolli i të cilave është në kompetencë të më shumë organeve inspektive; | 2.3. it is necessary to control the objects of particular importance for tourism, trade, hotels, and other traffic, for sampling, the control of which is in competence of more inspection bodies; | 2.3. ovo je neophodno za kontrolu objekata od posebnog značaja za turizam, trgovinu, hoteljijerstvo, saobraćaj i drugo, za uzorkovanje, čija kontrola je u nadležnosti više inspekcijskih organa; |
| 2.4. vlerësohet se mbikëqyrja në këtë mënyrë kryhet më shpejt, me më pak shpenzime dhe është më efikase; | 2.4. it's estimated that oversight in this manner is performed so quickly, with less cost and it's efficiently; | 2.4. procenjuje se da se nadzor na ovaj način vrši bre, sa manje troškova i efikasnija je; |
| 2.5. në raste tjera të përcaktuara me ligj. | 2.5. in other cases when determined by the law. | 2.5. u dugim slučajevima utvrđenim zakonom. |
| **Neni 51**<br>**Bashkëpunimi me organe tjera inspektuese** | **Article 51**<br>**Cooperation with other inspection bodies** | **Član 51**<br>**Saradnja sa drugim inspekcijskim organima** |
| 1. Në rast të kryerjes së mbikëqyrjes së përbashkët, organet inspektuese janë të obliguara: | 1. In the case of conducting joint supervision, inspection bodies are required to: | 1. U slučajevima zajedničkog nadzora, inspekcijski organi dužni su: |
| 1.1. t'i harmonizojnë programet dhe planet për punë dhe ta planifikojnë kryerjen e inspektimeve të | 1.1. to harmonize work plans and programs and to plan joint inspections; | 1.1. da usklade planove i programe za rad i druge poslove i da planiraju izvršenje zajedničkih inspekcija; |

| | | |
|---|---|---|
| përbashkëta; | | |
| 1.2. të shkëmbejnë përvoja dhe t'i harmonizojnë qëndrimet për mënyrën dhe metodat e punës; | 1.2. to exchange experiences and to harmonize their positions on the manner and methods of work; | 1.2. da razmene iskustva i da usklade svoje stavove o načinu i metodama rada; |
| 1.3. të mbajnë takime, konsultime, këshillime të përbashkëta dhe forma tjera të bashkëpunimit. | 1.3. to hold meetings, consultations, joint counseling and other forms of cooperation. | 1.3. da održe sastanke, konsultacije, zajedničko savetovanje i druge oblike saradnje. |
| 2. Nëse gjatë mbikqyrjes inspektuese organet inspektuese konstatojnë parregullsi, të cilat janë kompetencë e organit tjetër relevant, informohet organi kompetent. | 2. If during the inspection supervision inspection authorities find surveillance inspection irregularities, which are the competence of other relevant body, inform the competent authority. | 2. Ako u toku inspekcijskog nadzora inspekcijski organi utvrde nepravilnosti, koji su nadležnost drugog relevantnog organa, obaveštava se nadležni organ. |
| **KREU XV**<br>**DISPOZITAT NDËSHKIMORE** | **CHAPTER XV**<br>**PENALTY PROVISIONS** | **POGLAVLJE XV**<br>**KAZNENE ODREDBE** |
| **Neni 52**<br>**Kundërvajtjet** | **Article 52**<br>**Delinquency** | **Član 52**<br>**Prekršaji** |
| 1. Me gjobë në të holla prej njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5 000) Euro, gjobitet për kundërvajtje personi juridik. kurse pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro, gjobitet personi përgjegjës i personit juridik: | 1. With cash fine of one thousand (1,000) up to five thousand (5000) Euro, fine for the legal person, and five hundred (500) up to one thousand (1.000) euros, fined the responsible person or legal entity: | 1. Novčanom kaznom od hiljadu (1.000) do pet hiljada (5 000) evra, kaznit će se pravno lice, i pet stotina (500) do hiljadu (1.000) evra, kažnjeno odgovorno lice ili pravno lice: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. nuk vepron sipas kërkesës, përkatësisht afatit të caktuar me urdhër të inspektorit, neni 29, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. i këtij Ligji; | 1.1. not act accordingly with request, respectively deadline by order of the inspector, article 29, paragraph 1. subparagraph 1.1. of this Law; | 1.1. ne postupi u skladu sa zahtevom, odnosno prema nalogu ispektora, član 29, stav 1. podstav 1.1. ovog Zakona ; |
| 1.2. inspektorit nuk i mundëson kryerje të papenguar të mbikëqyrjes inspektuese, neni 29 paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. i këtij Ligji; | 1.2. does not allow the inspector unimpeded performance of inspection surveillance, article 29 paragraph 1. subparagraph 1.2. of this Law; | 1.2. inspektoru ne omogući nesmetan inspekcijski nadzor član 29 stav 1. podstav 1.2. ovog Zakona; |
| 1.3. inspektorit nuk i ofron dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme për procedurë të mbikëqyrjes inspektuese, neni 29 paragrafi 1. nën paragrafi 1.3. i këtij Ligji; | 1.3. does not provide to the inspector the documentation and data necessary for the inspection procedure, article 29 paragraph 1. subparagraph 1.3 of this Law; | 1.3. inspektoru ne obezbedi dokumentacija i potrebni podaci o nadzornom inspekcijskom postupku, član 29 stav 1. podstav 1.3. ovog Zakona; |
| 1.4. inspektorit nuk i siguron kushte të nevojshme për kryerjen e procedurës inspektuese, neni 29 paragrafi 1. nën paragrafi 1.4. i këtij Ligji; | 1.4. does not provide necessary conditions for conducting the inspection procedure, article 29 paragraph 1. sub paragraph 1.4. of this Law; | 1.4. inspektoru ne obezbede uslovi potrebni za vršenje inspekcijkog postupka, član 29 stav 1. podstav 1.4. ovog Zakona; |
| 1.5. inspektorit nuk i mundëson qasje në hapësira punuese dhe pajisje për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, neni 29 paragrafi 1. nën paragrafi 1.5. i këtij Ligji; | 1.5. does not allow the inspector to access to working space and equipment to perform inspection, article 29 paragraph 1. subparagraph 1.5. of this Law; | 1.5. inspektoru ne omogući pristup radnom prostoru i opremi za obavljanje inspekcijskog nadzora, član 29 stav 1. podstav 1.5. ovog Zakona; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.6. nuk kryen veprimet e detyruara gjatë procedurës inspektuese, për të vlerësuar gjendjen faktike, neni 29, paragrafi 1. nën paragrafi 1.7. i këtij Ligji; | 1.6. performs no action required during the inspection procedure to assess the real situation, article 29 paragraph 1. subparagraph 1.7. of this Law; | 1.6. vrši nikakvu akciju potrebno tokom inspekcijskog postupka na proceni stvarnu situaciju, član 29 stav 1. podstav 1.7. ovog Zakona; |
| 1.7. në afatin e caktuar, nuk i dorëzon ose përgatitë të dhënat, raportet, materialet dhe dokumentet tjera të nevojshme për procedurën e mbikëqyrjes inspektuese, neni 29 paragrafi 1. nën paragrafi 1.8. i këtij Ligji; | 1.7. in due course, not the deliver or prepare the data, reports, materials and documents other necessary procedures inspection oversight, article 29. paragraph 1. subparagraph 1.8. of this Law;; | 1.7. u utvrđenom roku ne dostaviti ili pripremiti podatke, izveštaja, materijala i dokumenata druge neophodne procedure inspekcijski nadzor, član 29 stav 1. podstav 1.8. ovog Zakona; |
| 1.8. në afatin e caktuar nuk zbaton masat e urdhëruara nga inspektori, përkatësisht nuk e informon atë me shkrim për kryerjen dhe zbatimin e atyre masave të urdhëruara, neni 31 paragrafi 2, i këtij Ligji; | 1.8. within the limited period due course does not implement the measures proposed by the inspector, respectively, did not inform him in writing for performance and implementation of those measures ordered, article 31. paragraph 2. of this Law; | 1.8. u utvrđenom roku ne sprovede mere predložene od inspektora, odnosno njega pismeno ne obavesti za obavljanje i sprovođenje naloženih mera, član 31 stav 2. ovog Zakona; |
| 1.9. për dyshimet e bazuara nga ana e inspektorit për ndonjë veprimtari të dyshuar që mund të jetë subjekt i inspektimit, nuk i mundësohet inspektorit kryerjen e kontrollit dhe mbikëqyrjen inspektuese, neni 32, i këtij Ligji; | 1.9. based on the inspector allegations for any suspected activities that may be subject to inspection, the inspector is not allowed to conduct the audit and inspection supervision, article 32. of this Law; | 1.9. za izmene navedenih od strane inspektora za bilo koju sumljivu aktivnost koja može biti subjekt inspekcije, ne omogući izvršenje inspekcijske kontrole i inspekcijskog nadzora, član 32. ovog Zakona; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.10. subjekti i mbikqyrës nuk zbaton kërkesat dhe afatin e përcaktuar në njoftimin për pezullimin e veprimtarisë nga inspektorati, neni 27, i këtij Ligji. | 1.10. supervisory entity does not implement the requirements and within time specified in the notice of suspension of activity of the inspectorate, article 27. of this Law. | 1.10. nadzorni entitet ne sprovodi zahtevi i rok naveden u obaveštenju o obustavljanju aktivnosti inspektorata, član 27. ovog Zakona. |
| 2. Me gjobë në të holla prej katërqind (400) deri në tetëqind (800) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik kurse dyqind (200) deri në katërqind (400)Euro personi përgjegjës i personit juridik në organin kompetent në nivel qendror dhe lokal, neni 24, paragrafi 1.2. i këtij Ligji. | 2. Cash fine of four hundred (400) to eight (800) Euro for the legal person shall be fined the legal entity for violation and two hundred (200) to four hundred (400) Euro the responsible person of state body at the local and central level, article 24, paragraph 1.2. of this Law. | 2. Novčanom kaznom od četristo (400) do osamsto (800) evra kažnjava se za prekršaj pravno lice i vesta (200) do četristo (400) evra lice odgovorno državnom organu na lokalnom i centralnom nivou, član 24, stav 1.2. ovog Zakona. |
| 3. Me gjobë në të holla prej treqind (300) deri në gjashtëqind (600) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik dhe njëqind (100) deri në dyqind (200) Euro personi përgjegjës në nivel lokal, neni 24 paragrafi 1.3. i këtij Ligji. | 3. Cash fine of three hundred (300) to six hundred (600) Euro for the legal person shall be fined the legal person for delinquency and one hundred (100) to two hundred (200) Euro the responsible person of state body at the local level, article 24, paragraph 1.3. of this Law. | 3. Novčanom kaznom od trista (300) do šesto (600) evra kažnjava se pravno lice i sto (100) do dvesta (200) evra lice odgovorno državnom organu na lokalnom nivou, član 24 stav 1.3. ovog Zakona. |
| **KREU XVI<br>ZBATIMI I LIGJIT DHE MBIKËQYRJA** | **CHAPTER XVI<br>LAW IMPLEMETATION AND SUPERVISION** | **POGLAVLJE XVI<br>SPROVOĐENJE ZAKONA I NADZOR** |
| **Neni 53** | **Article 53** | **Član 53** |
| 1. Mbikqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve | 1. Administrative supervision for the implementation of the provisions of this Law | 1. Inspekcijski nadzor o sprovođenju odredbi ovog zakona i podzakonskih akata |

| | | |
|---|---|---|
| nënligjore të nxjerrura nga ky ligj, e bënë Ministria. | and sub-legal acts issued by this law is conducted by the Ministry. | donetih iz ovog zakona, obavlja Ministarstvo. |
| 2. Mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore e kryen Inspektorati i Ministrisë. | 2. Inspection supervision in the implementation of the provisions of this law and sub-legal acts performs the Inspectorate of the Ministry. | 2. Inspekcijski nadzor na sprovođenju odredbi ovog zakona i podzakonskih akata obavlja Ministarstvo. |
| **KREU XVII**<br>**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE** | **CHAPTER XVII**<br>**TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE XVII**<br>**PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE** |
| **Neni 54**<br>**Zbatimi i Ligjit për procedurat e filluara** | **Article 54**<br>**Law Implementation for started procedures** | **Član 54**<br>**Sprovođenje Zakona o započetim postupcima** |
| Procedurat inspektuese të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të kryhen sipas rregullave të cilat kanë vlejtur para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. | Inspection procedures started before the entry into force of this Law, shall be conducted under the rules which were valid before the entry into force of this law. | Inspekcijski postupci pokrenutih pre stupanja na snagu ovog Zakona, izvršit će se prema pravilima koja su važila pre stupanja na snagu ovog zakona. |
| **Neni 55**<br>**Zbatimi i Ligjit për fushat përkatëse** | **Article 55**<br>**Implementation of the Law for the respective areas** | **Član 55**<br>**Sprovođenje zakona o relevantinim oblastima** |
| Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi që përfshijnë fushat përkatëse të mbikëqyrjes inspektuese, zbatohen nga inspektoratet e fushave përkatëse të përcaktuara në këto | Laws and regulations that include the respective fields of the supervision inspection are performed by inspectorates of respective areas defined in these laws. | Zakoni i podzakonski akti na snazi koji uključuju relevante oblasti inspekcijskog nadzora, sprovode se od inspektorata relevantinih oblasti određenim u ovim |

| | | |
|---|---|---|
| ligje. | | zakonima. |
| **Neni 56**<br>**Miratimi i akteve nënligjore** | **Article 56**<br>**Approval of sub-legal acts** | **Član 56**<br>**Usvajanje podzakonskih akata** |
| Ministria nxjerr aktet nënligjore të parapara me këtë Ligj, në afat prej një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. | The Ministry issues sub-legal acts foreseen in this Law, within one (1) year from the date of entry into force of this Law. | Ministarstvo donosi podzakonske akte predviđenim ovim Zakonom, u roku od jedne (1) godine nakon stupanja na snagu ovog Zakona. |
| **Neni 57**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 57**<br>**Entry into force** | **Član 57**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. | This law enters into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. | Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom Glasniku Republike Kosova. |
| Jakup Krasniqi<br>________________<br>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës | Jakup Krasniqi<br>________________<br>The President of the Assembly of the Republic of Kosovo | Jakup Krasniqi<br>________________<br>Predsednik Skupštine Republike Kosova |